



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
DREJTORIA E MIGRACIONIT, DIASPORES, PROJEKTEVE SOCIALE DHE
SEKTORI I ÇESHTJEVE SOCIALE

Nr. 2385 Prot

Fushë-Arrëz, më 07.08.2025

PROJEKT - VENDIM
Nr. 23 datë 07.08.2025

PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR PËR BARAZINË GJINORE 2025-2030


Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 "Per Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Neni 54 "Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak", pika k "Miraton norma, standarte e kriteret për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interesit publik", Ligji nr.9970, datë 24.7.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri", Vendimit nr. 400, date 30.6.2021 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, 2021-2030, dhe të planit të saj të veprimit". Ligji Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligji Nr. 125/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 9669, datë 18.12.2006 " Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", ndryshuar. Ligji Nr. 124/2020 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 10221/04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar. Ligji Nr. 35/2020 "Për një ndryshim në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar. Ligji Nr. 136/2015 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar. Ligji Nr. 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara". Ligji Nr.104/2014 "Per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligji Nr. 101/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligji Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligji Nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligji Nr. 65/2016 "Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë", Ligji Nr.

Penale", i ndryshuar, Ligji Nr. 79/2017 "Për sportin", Ligji Nr. 22/2018 "Për strehimin social" i ndryshuar, Ligji Nr. 15/2019 "Për nxitjen e punësimit" i ndryshuar, Ligji Nr. 75/2019 "Për rininë" i ndryshuar.


Ju paraqesim për diskutim dhe miratim:

1. Planin Vendor për Barazinë Gjinore 2025-2030 dhe planin e veprimit sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet, Drejtoria e Migracionit, Diaspores, Projekteve Sociale, për zbatimin e këtij Projekt -Vendimi pas miratimit të tij.

Konceptoi: Klotilda Curri



Konfirmoi: Sidorela Katroshi



KRYETARI

HIL CURRI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
DREJTORIA E MIGRACIONIT, INTEGRIMIT EVROPIAN, DIASPORES
DHE E ÇESHTJEVE SOCIALE
SEKTORI I ÇESHTJEVE SOCIALE

Nr. 2395 Prot

Fushë-Arrëz, më 07 . 08 .2025

RELACION

PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR PËR BARAZINË GJINORE 2025-2027

KËSHILLIT BASHKIAK

Të nderuar këshilltar,

Në mbledhje të Ligjit nr. 139/2015 “ Për vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Neni 54 “ Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak”, pika k “ Miraton norma, standarde e kriteret për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që janë dhënë atij në ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interesit publik”, Ligji nr.9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, Vendimit nr. 400, datë 30.06.2021 “ Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, 2021-2030, dhe të planit të saj të veprimi”, Ligji nr.68/2017 “ Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligji nr.125/2020 “ Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr 9669, datë 18.12.2006 “ Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, Ligji Nr.124/2020 “ Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.10221/04.02.2010 “ Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar , Ligji nr 35/2020 “ Për një ndryshim në ligjin nr 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji Nr. 136/2015 “ Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar , Ligji Nr. 101/2020 “ Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10019, datë 29.12.2008 “ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin 121/2016. “ Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr.69/2012 “ Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjin nr.18/2017 “ Për të drejtat dhe

mbrojtjen e fëmijës”, Ligji nr.37/2017 “ Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, Ligji nr.111/2017 “ Për ndihmen juridike të garantuar nga shteti” i ndryshuar, Ligji nr.35/2017 “ Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.03.1995, “ Kodi i procedurës penale”, i ndryshuar, Ligji nr.79/2017 “ Për sportin”, Ligji nr.22/2018 “ Për strehimin social” i ndryshuar, Ligji nr.15/2019 “ Për nxitjen e punësimit” i ndryshuar, Ligji

Ju paraqesim për diskutim dhe miratim projektvendimin për “ Planin Vendor për barazinë gjinore 2025-2027”, ka përgatitur dokumentin, “ Planin Vendor për barazinë gjinore 2025-2027”, ku ka të përcaktuar qartë vizionin, fushat kryesore të ndërhyrjes, rezultatet e pritshme, objektivat specifike dhe treguesit.

Vizioni:

“ Gratë dhe burrat, të rejat e të rinjtë, vajzat dhe dhe djemtë e Fushë-Arrëzit, pavarësisht moshës, vendbanimit, grupit etnik e social, aftësive të kufizuara e nevojave të vecanta, statusit civil, statusit të punësimit e gjendjes ekonomike, përkatësisë fetare, apo karakteristikave të tjera individuale , gëzojnë, respektojnë dhe kontribuojnë për përparimin drejt barazisë gjinore dhe zbatimin e saj në praktikë, në të gjitha fushat e jetës”.

Parimet që udhëheqin zbatimin e PVVBGJ, janë të njëjtat parime që udhëheqin në tërësi dhe zbatimin e Kartës Evropiane për Barazi të grave dhe burrave në jetën vendore , sic paraqiten në vijim:

1. Barazia ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve nga gjithë grupet , përbën një të drejtë themelore.
2. Për të siguruar barazinë gjinore duhet të trajtohen çështjet e diskriminimit dhe të pengesave të shumëfishta.

3. Pjesëmarrja e balancuar e grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve në vendimmarrje është parakusht për një shoqëri demokratike.
4. Eliminimi i stereotipave gjinorë ka rëndësi themelore për arritjen e barazisë gjinore.
5. Integrimi i këndvështrimit gjinor në të gjitha veprimtaritë e organeve të vetëqeverisjes vendore është i nevojshëm për të cuar përpara barazinë gjinore.
6. Planet e veprimit, të mbështetura me burimet e duhura, janë instrumente të nevojshme për cuarjen përpara të barazisë gjinore.

Fushat kryesore të ndërhyrjes:

PVVBJ 2021-2030, përbëhet nga katër fusha kryesore të ndërhyrjes, të cilat jo vetëm kanë në përmbajtje nene të ndryshme të Kartës Evropiane për Barazi, por janë harmonizuar edhe me një pjesë të objektivave specifike të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030, sidomos ato që përmbajnë masa dhe veprime specifike ku përgjegjës kryesorë për zbatim janë NJVV-të. Këto fusha ndërhyrjeje janë:

1. Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, si dhe fuqizimi i vajzave, të rejave dhe grave.
2. Rritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimi i grave dhe të rejave/ të rinjve në vendimmarje.
3. Liri nga të gjitha format e dhunës me bazë gjinore.
4. Integrimi gjinor në politikat vendore.

Secila nga këto fusha të ndërhyrjes është zbërthyer më tej në rezultatet e pritshme, objektivat specifike, treguesit e matjes së tyre, si dhe në masa e veprime konkrete, të cilat drejtohen në matricën e planit të veprimit, ku jepet një informacion më i plotë si për zbatimin dhe vlerësimin

e rezultateve, si dhe dokumenteve të tjerë kryesorë ku mund të referohemi , në përmbushje të veprimeve të parashikuara në secilen fushë ndërhyrjeje.

Përparimi dhe efektiviteti në zbatimin e PVVBGJ kërkon domosdoshmërisht vënien në dispozicion të burimeve të nevojshme dhe të mjaftueshme njerëzore, financiare e infrastrukturore, si dhe kordinimin e veprimeve dhe bashkëpunimin ndërinstitucional me institucionet e tjera vendore, organizatat e shoqërisë civile, bizneset, si dhe organizata ndërkombëtare të cilat punojnë për fuqizime grave dhe arritjen e barazisë gjinore . Mbledhja dhe përditësimi rregullisht i të dhënave të ndara jo vetëm sipas gjinisë, por edhe sipas një tërësie karakteristikash të tjera individuale, monitorim i vazhdueshëm mbi ecurinë e zbatimit të veprimeve të parashikuara, si dhe transparenca e llogaridhënia për rezultatet e arritura, janë gjithashtu domosdoshmëri për të përparuar drejt vizionit që udhëheq këtë PVVBGJ.

Rezultatet e pritshme, objektivat specifike dhe treguesit.

Fusha e ndërhyrjes:

1. Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, si dhe fuqizimi i vajzave, të rejave dhe grave.

Objektivat specifikë:

Rritja e qasjes së grave dhe të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, ndaj shërbimeve, produkteve dhe burimeve financiare që ndikojnë në fuqizimin ekonomik të tyre.

Fusha e ndërhyrjes:

2. Rritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grave dhe të rejave, ronjve në vendimmarrje.

Objektivat specifikë:

Rritja e pjesëmarrjes në vendimmarrjen politike, për gratë, të reja dhe vajzat në të gjithë diversitetin e tyre.

Fusha e ndërhyrjes:

3. Liri nga të gjitha format e dhunës me bazë gjinore.

Objektivat specifikë:

Fuqizimi dhe rritja e efencës së Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të Rasteve të Dhunës me Bazë Gjinore.

Fusha e ndërhyrjes:

4. Integrimi gjinor në politikat vendore.

Objektivat specifikë:

Përgjegjshmëria dhe transparencja e bashkisë mbi përmbushjen e angazhimeve publike për barazinë gjinore.

Konceptoi: Klotilda Curri



Konfirmoi: Sidorela Katroshi



KRYETARI

